



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1879/1 prot

Datë 16.07.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË
DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SH.A, në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-46805-05-02-2025, me objekt: “*Loti 2 - Blerje bateri për automjete*”, me fond limit 39,522,590.84 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 04-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** “Alked Kopaçi” PF, me NIPT (K41510041C), me adresë: Njesia Bashkiake nr 7, Rruga e Kavajes , Pallati nr 102, Shkalla nr 1, Kodi postar 1023, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** “Kappa” SHA me NIPT J91402501L dhe adresë Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Zona Kadastrale 2547, Nr.Pasurie 159/182, Vol 19, Fq 219.

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5557, datë 15.07.2025 dhe me nr. protokolli 1879/2025 datë 15.07.2025 e operatorit ekonomik “Alked Kopaçi” PF për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë*”

monetar”, me Nr. REF-46805-05-02-2025, me objekt: “Loti 2 - Blerje bateri për automjete”, me fond limit 39,522,590.84 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 04-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kappa” SHA.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/ skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “Alked Kopaçi” PF me anë të ankesës me nr. A/2025/5557, datë 15.07.2025 dhe me nr. protokolli 1879/2025 datë 15.07.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Kappa” SHA, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime si më poshtë citojmë:

“2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe / ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/ nje dokument nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuar (ku të provohet lidhja me prodhuesin) se është i autorizuar të tregtojë mallrat objekt prokurimi.

2.3.3. *Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit. Dokumenti duhet të jetë në gjuhën shqipe ose në anglishte.”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 16.07.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro